

محمد بن عبد الله



# LETRA E IMAM SADIKUT

(Paqja qoftë mbi të!)

## PËR SHOKËT E TIJ

Tiranë, 2025

**Titulli: Letra e Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) për shokët e tij**

**I përktheu nga arabishtja: Haxhi Shejkh  
Vullnet MERJA**

**I redaktoi: Jerida KULLA**

**I korrektoi: Ma. Isra MERJA**

**Përkujdesja kompjuterike: Sabrie FEZA**

**Kopertina: Sabrie FEZA**

**Botoi: Shoqata "FLLADI" - Tiranë, 2025**

## **Letra e Imam Sadikut** (Paqja qoftë mbi të!) **për shokët e tij**

Është transmetuar se Imam Ebu Abdullahu, Es Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) u shkroi këtë letër shokëve të tij dhe i urdhëroi që ta mësonin, ta shqyrtonin, ta ruanin dhe të vepronin sipas saj. Ata e vendosnin në xhamitë dhe në shtëpitë e tyre dhe, sa herë që përfundonin faljen, e lexonin atë.

Hasan ibn Muhamedi ka transmetuar nga Xhaferrr ibn Muhamed

ibn Malik el Kufi, nga Kasim ibn Rabi es Sahafi, nga Ismail ibn Mukhled Es Rrraxh, se Ebu Abdullahu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kjo letër doli nga Ebu Abdullahu për shokët e tij:

**“Me emrin e Allahut, të  
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

Luteni Zotin tuaj për shëndet! Jini të përmbajtur, të qetë, të qëndrueshëm e të urtë. Jini të pastër fizikisht e shpirtërisht! Largohuni nga ato që të mirët para jush janë larguar.

Silluni me butësi ndaj njerëzve të së kotës (të së pavërtetës), duroni padrejtësinë që vjen prej tyre dhe ruhuni nga përplasja dhe grindja me ta. Silluni me

devotshmëri në raportet që keni me ta, kur uleni bashkë, kur përziheni me ta dhe kur debaton, sepse, patjetër që do t'ju duhet t'i shoqëroni, të keni lidhje dhe të debaton me ta. Por bëjeni këtë me takije (fshehjen e bindjes për mbrojtje), ashtu siç ju ka urdhëruar Allahu që të veproni mes jush dhe atyre.

Kur të sprovoheni prej tyre, ata do t'ju dëmtojnë dhe në fytyrat e tyre do të shihni shenjat e urrejtjes. Sikur Allahu i Lartësuar të mos i largonte ata nga ju, do t'ju kishin sulmuar me forcë, sepse ajo që fshehin në zemrat e tyre, nga armiqësia dhe urrejtja, është edhe më e madhe se ajo që shfaqin ndaj jush.

Tubimet tuaja dhe tubimet e tyre janë të njëjta (në dukje), por shpirtrat tuaj dhe shpirtrat e tyre janë të ndryshëm, ata nuk përputhen kurrë. Ju kurrë nuk i doni ata dhe as ata nuk ju duan juve. Mirëpo Allahu i Lartësuar ju ka nderuar me të vërtetën dhe jua ka hapur sytë ndaj saj. Ata nuk i ka bërë ndër njerëzit e saj (të së vërtetës), prandaj ju silluni me butësi ndaj tyre dhe duroni përballë tyre, edhe pse ata nuk kanë as butësi, as durim për asgjë. Mashtrimet e tyre janë pëshpërma të njëritjetrit, sepse armiqtë e Allahut, nëse do të mundnin, do t'ju largonin nga e vërteta. Por Allahu ju ruan prej kësaj. Prandaj kini frikë Allahun dhe përmbajeni gjuhën tuaj përveç në të mirën. Kujdesuni që gjuhët tuaja të mos rrëshqasin në fjalë të rreme,

shpifje, mëkat dhe armiqësi, sepse, nëse i përmbani gjuhët tuaja nga ato që Allahu i urren dhe ua ka ndaluar, kjo është më e mirë për ju te Zoti juaj, se sa t'i lini të rrëshqasin në atë që Ai e urren, sepse, rrëshqitja e gjuhës në atë që Allahu e urren dhe e ka ndaluar, është shkatërrim për robin tek Allahu, ngjall zemërimin e Tij dhe bën që Allahu ta bëjë njeriun shurdh, të verbër e memec në Ditën e Kiametit.

Kështu që ju bëheni ashtu siç ka thënë Allahu: **“Shurdh, memecë e të verbër, e nuk kthehen** (në rrugën e së vërtetës)”, që do të thotë: nuk mund të flisni, as nuk do t'u jepet leje të shpreheni.

Ruhuni nga çdo gjë që Allahu ju ka ndaluar dhe mos e bëni atë. Jini të heshtur, përveçse kur flisni për diçka që ju sjell dobi prej Allahut në çështjet e Botës Tjetër dhe për të cilën Ai ju shpërblen.

Thoni sa më shumë: “La ilahe il l’Allah”-“S’ka zot tjetër përveç Allahut!”, “Subhanallah”-“I Lartësuar është Allahu!”, “Elhamdulillah”-“Falënderimi është për Allahun!”. Lavdërojeni Allahun, përuluni me lutje ndaj Tij dhe dëshironi atë që gjendet tek Ai nga mirësitë, të cilat askush nuk mund t’i përshkruajë, as t’i imagjinojë me mendje. Prandaj, kujdesuni për gjuhët tuaja, duke e përkujtuar sa më shumë Allahun, mos përdorni fjalë të kota, të cilat Allahu i ka ndaluar, sepse ato janë fjalë të

pavërteta që i çojnë ata që i thonë drejt qëndrimit të përhershëm në zjarr, nëse vdesin mbi to pa u penduar dhe pa u tërhequr prej tyre.

Përmbajuni fort lutjes (duasë), sepse myslimanët nuk kanë arritur ndonjë mënyrë më të vlefshme për të fituar përgjigje te Zoti i tyre, se sa me lutje, përulje dhe kërkim nevojë prej Tij. Dëshironi me gjithë zemër atë që Allahu ju ka nxitur të dëshironi dhe përgjigjuni thirrjes së Tij, që të shpëtoni dhe të ruheni nga dënimi i Allahut. Ruhuni që shpirtrat tuaj të mos lakmojnë asgjë që Allahu ua ka ndaluar, sepse kush shkel ndalesat e Allahut në këtë botë, Allahu do ta pengojë përjetësisht të hyjë në Xhenet dhe të

përfitojë prej kënaqësisë, lumturisë dhe nderit të përhershëm të banorëve të Xhenetit.

Dijeni se shumë i keq është fati i atij që rrezikon përballë Allahut, duke braktisur bindjen ndaj Tij dhe duke bërë mëkat, e që zgjedh të shkelë kufijtë e Allahut për kënaqësitë kalimtare e të shkurtra të kësaj bote, duke humbur lumturinë e përjetshme të Xhenetit, kënaqësinë dhe nderin e banorëve të tij.

Mjerë ata! Sa i mjerë është fati i tyre, sa i humbur është kthimi i tyre dhe sa e rëndë do të jetë gjendja e tyre te Zoti në Ditën e Gjykimit!

Kërkoni strehim tek Allahu, që Ai të mos ju bëjë kurrë si shembulli i tyre dhe të mos ju sprovtojë me atë që i sprovoi ata, sepse nuk kemi fuqi e as mbështetje, përveçse tek Ai. Prandaj, kini frikë Allahun, o ju grupi i shpëtuar, nëse Allahu e plotëson për ju atë që ju ka premtuar, sepse puna nuk do të përfundojë, deri sa të kaloni të njëjtat sprova siç kaluan të mirët para jush. Do të sprovoheni në veten tuaj, në pasuritë tuaja dhe nga armiqtë e Allahut do të dëgjoni fjalë e veprime që do t'ju lëndojnë shumë, por durojini dhe jini të qëndrueshëm. Ata do t'ju nënçmojnë, do t'ju urrejnë, do t'ju bëjnë padrejtësi, por ju duroni për hir të Allahut dhe për Botën Tjetër. Kur t'ju ngacmojnë me fjalë e vepra, për shkak të Allahut të Madhëruar, ju

përmbajeni zemërimin tuaj; kur t'ju gënjejnë për të vërtetën, t'ju armiqësojnë për të dhe t'ju urrejnë për shkak të saj, përballojeni këtë me durim, sepse e gjithë kjo është e vërtetuar në Librin e Allahut, të cilin Xhibrili (Paqja qoftë mbi të!) ia zbriti Profetit tuaj (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Ju e keni dëgjuar fjalën e Allahut të Madhëruar drejtuar Profetit tuaj (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): **“Prandaj, duro ashtu siç duruan të dërguarit me vendosmëri (Ulul ‘Azm) dhe mos u ngut për ta (mos kërko shpejt ndëshkimin e tyre)”**.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Sure “El Ahkaf”, ajeti 35.

**Gjithashtu, Ai thotë: “Nëse ata të përgënjeshtrojnë, edhe para teje janë përgënjeshtruar të dërguar, por ata duruan përballë përgënjeshtimit dhe lëndimeve”.<sup>2</sup>**

Pra, edhe Profeti i Allahut tuaj (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe të dërguarit para tij u përgënjeshtruan dhe u munduan me lëndime për shkak të së vërtetës. Nëse ju gëzon ajo që Allahu ka vendosur për ta, për njerëzit që Ai i ka krijuar për këtë qëllim, që në fillim të krijimit, atëherë dijeni se në dijen e përjetshme të Allahut ishte përcaktuar që disa njerëz të krijoheshin

---

<sup>2</sup> Sure “El En’am”, ajeti 34.

mosbesues (kufr), ashtu siç tha Allahu në Librin e Tij: **“Dhe Ne prej tyre bëmë udhëheqës që thërrasin në zjarr”.**<sup>3</sup> Prandaj, mendoni thellë për këtë dhe kuptojeni mirë, mos u tregoni të paditur për të, sepse kush e injoron këtë dhe gjëra të ngjashme që Allahu i ka bërë detyrime në Librin e Tij, nga ato që Ai ka urdhëruar e ka ndaluar, ai ka braktisur fenë e Allahut dhe ka ndjekur mëkatet, duke e bërë veten të meritojë zemërimin e Allahut. Allahu do ta rrëzojë atë me fytyrë në zjarr.

O ju grup i mëshiruar dhe i shpëtuar! Allahu e ka plotësuar për ju të mirën që ju ka dhënë. Dijeni se nuk është

---

<sup>3</sup> Sure “El Kasas”, ajeti 41.

nga dija e Allahut e as nga urdhri i Tij që dikush prej krijesave të Allahut të marrë çështjet e fesë sipas dëshirës, mendimit apo matjeve të veta (krahasimeve njerëzore). Allahu ka zbritur Ku'ranin dhe në të ka bërë sqarimin e çdo gjëje, dhe për Kur'anin ka caktuar njerëz të veçantë ,për ta mësuar dhe për ta shpjeguar atë. Nuk u lejohet atyre që Allahu u ka dhënë dijen e Kur'anit, të flasin për të sipas dëshirës, mendimit apo krahasimit, sepse Allahu i ka bërë të panevojshëm për këto me dijen që u ka dhënë dhe i ka nderuar, duke e vendosur atë dituri tek ata. Ata janë Njerëzit e Përkujtimit (*Ehlu Dhikr*), të cilët Allahu ia ka urdhëruar këtij umeti t'i pyesë. Janë ata që, nëse dikush i pyet dhe në dijen e Allahut është shkruar se ai do t'i

besojë dhe do të ndjekë gjurmët e tyre, ata do ta udhëzojnë dhe do t'i japin nga dija e Kur'anit atë që do ta udhëzojë drejt Allahut, me lejen e Tij dhe drejt të gjitha rrugëve të së vërtetës.

Ndërsa ata që nuk duan t'i pyesin ata, që largohen nga dija e tyre dhe nga ajo me të cilën Allahu i ka nderuar, janë njerëzit për të cilët, në dijen e përjetshme të Allahut, është shkruar mjerimi, që prej fillimit të krijimit, nën hijen e caktimit hyjnor. Këta njerëz largohen nga pyetja e Njerëzve të Përkujtimit, të cilëve Allahu u ka dhënë dijen e Kur'anit, e ka vendosur atë dituri tek ata dhe ka urdhëruar që të pyeten për të. Këta që largohen, janë ata që ndjekin dëshirat, mendimet dhe

krahasimet (logjikën e vet), ngaqë djalli ka hyrë në ta, sepse ata kanë bërë që njerëzit e besimit, sipas dijes së Allahut në Kur'an, t'i shpallin jobesimtarë, kurse njerëzit e humbjes, sipas dijes së Allahut në Kur'an, t'i shpallin besimtarë. Madje, në shumë raste ata e kanë shpallur të ndaluar atë që Allahu e ka lejuar, dhe të lejuar atë që Allahu e ka ndaluar. Ky është fryti i parë i ndjekjes së dëshirave të tyre. Profeti i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) u kishte marrë një besëlidhje të qartë para vdekjes së tij, por ata thanë: "Pasi Allahu e mori të Dërguarin e Tij, ne kemi të drejtë të ndjekim mendimin e njerëzve për ata që janë rënë dakord pas vdekjes së tij, edhe pse kjo bën ndesh me atë që Allahu dhe i Dërguari i Tij

na kishin urdhëruar". S'ka njeri më të guximshëm ndaj Allahut, as më të qartë në humbje, se ai që vepron sipas kësaj dhe mendon se kjo është e lejueshme për të.

Pasha Allahun! Allahu ka detyrë mbi krijesat e Tij që t'i binden Atij dhe të ndjekin urdhrin e Tij, si në kohën e jetës së Muhamedit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ashtu edhe pas vdekjes së tij.

A mund të pretendojnë ata armiq të Allahut se dikush nga ata që besuan bashkë me Muhamedin (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) veproi sipas mendimit, dëshirës apo krahasimeve të vet? Nëse thonë

“po”, atëherë kanë gënjyer ndaj Allahut dhe janë shmangur rëndë nga e vërteta. E nëse thonë “jo”, pra se askujt nuk i lejohej të ndiqte mendimin, dëshirën apo logjikën e tij kundër urdhrit të Profetit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) , atëherë ata vetë e kanë pranuar argumentin kundër vetes.

Ndërkohë, ata vetë pretendojnë se pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) duhet t’i binden Allahut dhe të ndjekin urdhrin e Tij! Allahu i Lartësuar ka thënë dhe fjala e Tij është e vërtetë: **“Muhamedi nuk është tjetër veçse një i dërguar; edhe para tij kanë kaluar të dërguar të tjerë. A do të**

**ktheheni pas, nëse ai vdes apo vritet? Ai që kthehet prapa, nuk i bën dëm Allahut asgjë, dhe Allahu do t'i shpërblejë mirënjohësit".<sup>4</sup>**

Duhet ta kuptoni se bindja ndaj Allahut dhe ndjekja e urdhrave të Tij janë të detyrueshëm, si në jetën e Muhamedit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ashtu edhe pas vdekjes së tij. Dhe ashtu siç askujt prej njerëzve nuk i lejohej në kohën e Muhamedit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) të ndiqte dëshirat, mendimet apo krahasimet e veta, në kundërshtim me urdhrin e tij, po kështu, askujt nuk i lejohet

---

<sup>4</sup> Sure "Al Imran", ajeti 144.

as pas tij, të ndjekë dëshirat, mendimet apo krahasimet e veta në kundërshtim me urdhrin e tij.

Lërinin ngritjet e duarve në namaz, përveç një herë të vetme, kur e filloni namazin, sepse njerëzit ju kanë bërë të njohur për këtë (praktikë). Vetëm prej Allahut kërkohet ndihma dhe nuk ka fuqi, as forcë përveçse me Allahun. Shtoni lutjet tuaja ndaj Allahut, sepse Allahu i do robërit e Tij besimtarë, që e lusin Atë. Allahu ua ka premtuar besimtarëve që i luten Atij se do t'u përgjigjet lutjeve të tyre. Allahu do t'i bëjë lutjet e besimtarëve në Ditën e Kiametit si vepra (të mira), që do t'ua shtojnë shpërblimin në Xhenet. Prandaj shtoni përmendjen (dhikrin) e

Allahut sa të mundeni, në çdo orë të ditës dhe të natës, sepse Allahu ka urdhëruar për përmendje të shumtë të Tij. Allahu e përmend me të mirë atë besimtar që gjithmonë jeton me emrin e Allahut në gojë. Dijeni se askush prej robërve besimtarë, që e përmend Allahun, nuk e përmend Allahu veçse me të mirë.

Prandaj përpikuni vazhdimisht që të jepni më të mirën nga vetja juaj, duke adhuruar Allahun dhe duke iu bindur Atij, sepse asgjë nga e mira që ndodhet tek Allahu nuk arrihet përveçse me bindje ndaj Tij dhe me shmangie nga ndalesat që Allahu i ka ndaluar, qoftë në pamjen e jashtme të Kur'anit apo në kuptimin e tij të brendshëm. Allahu i Lartësuar ka thënë në

Librin e Tij dhe fjala e Tij është e vërteta: **“Lëreni mëkatin e dukshëm dhe të fshehtë”**.<sup>5</sup>

Dijeni se çdo gjë që Allahu ka urdhëruar ta shmangni, e ka bërë të ndaluar. Ndiqni gjurmët e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Sunetin e tij, kapuni pas tyre dhe mos ndiqni epshet dhe mendimet tuaja, se do të humbni. Më i humburi tek Allahu është ai që ndjek epshin dhe mendimin e vet pa udhëzim nga Allahu.

Bëni mirë ndaj vetes suaj sa të mundeni, sepse, nëse bëni mirë, e bëni për

---

<sup>5</sup> Sure “El En’am”, ajeti 120.

veten tuaj dhe, nëse bëni keq, kundër vetes tuaj e bëni. Silluni mirë me njerëzit dhe mos i ngarkoni ata mbi supet tuaja (mos ua ngarkoni gabimet e tyre vetes) dhe bashkoni me këtë bindjen ndaj Zotit tuaj.

Ruhuni nga sharja e armiqve të Allahut, në vende ku ata mund t'ju dëgjojnë, e pastaj të shajnë Allahun nga armiqësia, pa dituri.

Duhet ta dini se si është kufiri i sharjes së tyre ndaj Allahut: kush i shan miqtë e Allahut, ka cenuar (sharë) vetë Allahun. Kush është më i padrejtë para Allahut se ai që shkakton që të sharat të drejtohen ndaj Allahut dhe ndaj miqve të Tij?

Prandaj, ngadalë, ngadalë, ndiqni urdhrin e Allahut! Nuk ka fuqi, as forcë përveçse me Allahun.

O grup që Zoti e ka ruajtur çështjen tuaj! Mbahuni fort pas gjurmëve të të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), pas Sunetit të tij dhe pas gjurmëve e udhëzimeve të imamëve udhëzues nga Ehli Bejti i të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) pas tij, dhe pas sunetit të tyre, sepse kushdo që e merr këtë rrugë, është i udhëzuar e, kush e lë dhe shmanget prej saj, ka humbur. Allahu ka urdhëruar që t'u bindemi atyre dhe t'i marrim për kujdestarë (ulul emr).

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: “Vazhdimësia në vepra, duke ndjekur gjurmët dhe sunetet (e profetëve dhe imamëve), edhe nëse janë të pakta, është më e dashur për Allahun dhe më e dobishme tek Ai në fundin e punës, se sa përpjekja për të futur diçka të re, jashtë fjalës së Allahut dhe se ndjekja e dëshirave (epsheve)”.

Ndjekja e epsheve dhe të rejave të shtuara, pa udhëzim nga Allahu, është humbje; çdo humbje është bidat dhe çdo bidat përfundon në zjarr. Asgjë nga e mira nuk arrihet tek Allahu përveçse me bindje ndaj Tij, me durim dhe me kënaqësi (me

caktimin e Tij)), sepse durimi dhe kënaqësia janë pjesë e bindjes ndaj Allahut.

Dijeni se askush nga robërit e Tij nuk beson me besim të plotë, deri sa të jetë i kënaqur me Allahun në çdo gjë që Ai ka caktuar për të, qoftë në atë që e do apo në atë që e urren. Allahu nuk do të bëjë për ndonjë që është i durueshëm dhe i kënaqur me Të, veçse atë që i takon dhe që është më e mirë për të, në atë që e do dhe në atë që e urren.

Mbahuni fort pas namazeve, veçanërisht pas namazit të mesëm; qëndroni para Allahut me përulësi, ashtu siç Ai ka urdhëruar besimtarët në Librin e Tij, para jush.

Kini kujdes! Duajini të varfrit myslimanë, sepse, kush i përçmon ata dhe krenohet përballë tyre, ka dalë nga feja e Allahut. Allahu e përçmon dhe e urren atë. I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Zoti im më ka urdhëruar që t’i dua të varfrit myslimanë”.

Dijeni se kush e përçmon një mysliman, Allahu e mbulon me përçmim dhe me poshtërim, deri sa ta urrejnë njerëzit. Allahu e urren më shumë se ata. Prandaj kini frikë Allahun, për vëllezërit tuaj myslimanë të varfër, sepse ata kanë mbi ju një të drejtë, që t’i doni. Allahu e urdhëroi të Dërguarin e Tij që t’i dojë ata dhe, kush nuk e do atë që Allahu

ka urdhëruar ta dojë, ka mëkatuar ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij; kush vdes në atë gjendje, vdes si i humbur.

Kini kujdes nga madhështia dhe mendjemadhësia, sepse madhështia është petku i Allahut të Lartësuar. Kush përpiqet t'ia marrë këtë petk Allahut, Allahu e copëton dhe e poshtëron në Ditën e Kiametit.

Kini kujdes që të mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit, sepse padrejtësia nuk është cilësi e të drejtëve. Kush bën padrejtësi ndaj tjetrit, Allahu do ta kthejë padrejtësinë e tij mbi veten e tij dhe ndihma e Allahut do të jetë me atë që i është bërë

padrejtësi. Kush e ndihmon Allahu, ai fiton dhe gëzon triumfin nga Allahu.

Kini kujdes nga smira (zilia), sepse rrënja e kufrit është smira.

Kini kujdes nga mosndihma e ndonjë mysliman që i bëhet padrejtësi, e ai pastaj të lutet kundër jush, sepse Allahu ia pranojë atij lutjen. I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Lutja e myslimanit që i është bërë padrejtësi, pranohet”.

Ndihmojeni njëri-tjetrin, sepse i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Ndihma ndaj një myslimani

është më e mirë dhe ka shpërblim më të madh se agjërimi i një muaji dhe qëndrimi në adhurim në Xhaminë e shenjtë”.

Kini kujdes të mos e vështirësoni (pengoni) ndonjë mysliman që është në vështirësi për diçka që ju ka borxh, sepse i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Nuk i lejohet një myslimani ta vështirësojë një mysliman tjetër. Kush e lehtëson dikë që është në vështirësi, Allahu do ta vendosë nën hijen e Tij ditën kur nuk ka hije tjetër veçse hija e Tij”.

O grup i mëshiruar e i dalluar mbi të tjerët! Kini kujdes të mos vononi dhënien e të drejtave të Allahut që ju takojnë, ditë

pas dite, orë pas ore, sepse kush e shpejton dhënien e të drejtave të Allahut, Allahu është më i aftë ta shpejtojë për të shpërblimin, duke ia shumëfishuar të mirat në këtë botë dhe në tjetrën. E kush i vonon të drejtat e Allahut, Allahu është më i aftë t'ia vonojë atij furnizimin. Kushdo që Allahu ia ndalon furnizimin, nuk është në gjendje të furnizojë vetveten.

Jepjani Allahut të drejtën që ju ka dhënë në furnizimin tuaj, që Allahu t'jua bekojë pjesën tjetër dhe t'jua përmbushë premtimin për shumëfishim të madh, numrin dhe vlerën e të cilit nuk e di askush përveç Allahut, Zotit të botëve.

Kini frikë Allahun, o grup i mëshiruar! Nëse mundeni, mos u bëni prej atyre që e vendosin Imamin në pozitë të vështirë, sepse “ai që e vendos Imamin në pozitë të vështirë”, është ai që shpif ose i përgojon njerëzit e devotshëm, ndjekës të Imamit, besimtarë në virtytet e tij, durimtarë në kryerjen e të drejtave të tij dhe e njohin shenjtërinë e tij.

Dijeni se kush bën diçka të tillë në praninë e Imamit, ai e vë Imamin në pozitë të vështirë. Kur Imami detyrohet nga këta armiq të Allahut të mallkojë njerëzit e drejtë prej ndjekësve të tij, besimtarë në virtytin e tij, durimtarë në të drejtat e tij dhe njohës të shenjtërisë së tij, atëherë mallkimi i Imamit për ta (nën detyrim) bëhet

mëshirë nga Allahu për ta, ndërsa mallkimi nga Allahu, engjëjt dhe të dërguarit e Tij bie mbi ata (armiqtë që e shtynë Imamin ta bëjë këtë).

Dijeni, o grup (i besimtarëve të sinqertë), se ligji i Zotit ka qenë gjithmonë i njëjtë për të drejtët, edhe më parë (para jush). Kushdo që dëshiron ta takojë Allahun, si besimtar i vërtetë, le ta marrë për kujdestar Allahun, të Dërguarin e Tij dhe ata që kanë besuar (imamët e udhëzuar) dhe le të shkëputet nga armiqtë e tyre, si dhe le t'i dorëzohet Allahut, për sa u përket virtyteve dhe pozitës së tyre. Virtytet e tyre nuk i arrin asnjë engjëll i afërt (te Allahu), as ndonjë peygamber i

dërguar e as ndokush tjetër më poshtë se ata.

A nuk e keni dëgjuar fjalën e Allahut për vlerën e ndjekësve të imamëve udhëzues, të cilët janë besimtarë, kur thotë: **“Ata do të jenë me ata që Allahu u ka dhënë mirësi, me profetët, të sinqertët, dëshmorët dhe të drejtët. E sa shoqërim i mirë është ai!”**<sup>6</sup> Kjo është një anë nga anët e vlerës së ndjekësve të imamëve udhëzues. E çfarë të thuhet, atëherë, për vetë ata dhe për virtytet e tyre?!

Kush dëshiron që Allahu ta përfundojë besimin e tij dhe ta bëjë besimtar të vërtetë, në çdo kuptim, le t'i

---

<sup>6</sup> Sure “En Nisa”, ajeti 69.

përmbahet kushteve që Allahu ka vënë për besimtarët. Allahu, përveç urdhrit për dashurinë ndaj Tij, ndaj të Dërguarit të Tij dhe ndaj imamëve të besimtarëve, ka vendosur edhe kushte të tjera: faljen e namazit, dhënien e zekatit, dhënien e “borxhit të mirë” ndaj Allahut (që nënkupton bamirësinë dhe flijimin në rrugën e Tij) dhe shmangien nga të këqijat dhe turpet, si ato që janë të dukshme, ashtu edhe ato që janë të fshehta. Pra, nuk ka mbetur asgjë nga ato që Allahu i ka ndaluar e i ka sqaruar në Librin e Tij, që të mos jetë përfshirë në këtë urdhër.

Kush i përmbahet fesë së Allahut mes Tij dhe vetvetes, me sinqeritet, pa i lejuar vetes ndonjë lehtësi në moszbatimin

e asnjërit prej këtyre urdhrave, ai është, tek Allahu, ndër pjesëtarët e “grupit të Tij fitimtar” dhe është prej besimtarëve të vërtetë.

Kini kujdes! Mos këmbëngulni në asgjë nga ato që Allahu i ka ndaluar, qoftë në dukje apo në fshehtësi. Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe ata nuk këmbëngulën në atë që bënë, duke e ditur (gabimin e tyre)”**.<sup>7-8</sup>

Pra, kuptimi është se besimtarët para jush, kur harronin diçka nga ato që Allahu i kishte bërë detyrim në Librin e Tij dhe e kuptonin se kishin mëkatuar, duke e

---

<sup>7</sup> Sure “Al Imran”, ajeti 135.

<sup>8</sup> Këtu përfundon rrëfimi i Kasim ibn Rabi’it.

lënë atë gjë, ata kërkonin falje dhe nuk përsëritnin më gabimin.

Kjo është domethënia e fjalës së Allahut: **“Dhe ata nuk këmbëngulën në atë që bënë, duke e ditur”**. Dijeni se Allahu ka urdhëruar dhe ka ndaluar vetëm që t’i binden në atë që ka urdhëruar dhe të ndalohet nga ajo që ka ndaluar. Pra, kush ndjek urdhrat e Tij, e ka bindur Atë dhe ka arritur çdo të mirë që është tek Ai. Ndërsa kush nuk ndalet nga ajo që Allahu e ka ndaluar, e ka kundërshtuar Atë dhe, nëse vdes në këtë gjendje të mëkatit, Allahu do ta përmbysë me fytyrë në zjarr.

Dijeni se midis Allahut dhe ndonjë prej krijesave të Tij nuk ka as ndonjë engjëll

të afruar, as ndonjë profet të dërguar, e as ndonjë tjetër, përveç bindjes ndaj Tij. Prandaj përpikuni fort në bindjen ndaj Allahut, nëse dëshironi të jeni besimtarë të vërtetë. S'ka fuqi e s'ka forcë veçse prej Allahut.

Mbahuni fort pas bindjes ndaj Zotit tuaj, aq sa të keni mundësi, sepse Allahu është Zoti juaj. Dijeni se Islami është nënshtrim dhe nënshtrimi është Islam. Pra, kush i nënshtrohet Allahut, ka hyrë në Islam e, kush nuk i nënshtrohet, nuk ka Islam.

Kush dëshiron t'i bëjë vetes së tij mirësi, le t'i bindet Allahut, sepse ai që i bindet Allahut, ka bërë më të mirën për

vetveten. Ruhuni prej mëkateve ndaj Allahut, që të mos i kryeni ato, sepse ai që shkel ndalesat e Allahut dhe i kryen ato, ka bërë të keqen më të madhe ndaj vetes. Nuk ka ndonjë gradë të ndërmjetme midis mirësisë dhe të keqes: Për njerëzit e mirë, te Zoti i tyre është Xheneti; Për njerëzit e këqij, te Zoti i tyre është Zjarri (Xhehenemi). Prandaj, veproni sipas bindjes ndaj Allahut dhe largohuni nga mëkatet e Tij.

Dijeni se asnjë nga krijesat e Allahut nuk mund t'ju shpëtojë nga dënimi i Tij, as engjëll i afruar, as profet i dërguar, as kushdo tjetër. Kush dëshiron të përfitojë nga ndërmjetësimi (shefati) i ndërmjetësuesve pranë Allahut, le t'i lutet

Allahut që Ai të jetë i kënaqur me të. Askush nga krijesat e Allahut nuk ka fituar kënaqësinë e Allahut përveçse me bindjen ndaj Tij, ndaj të Dërguarit të Tij dhe ndaj kujdestarëve të çështjeve (ulil-emr) nga Ehli Bejti i Muhamedit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Mosbindja ndaj tyre është mosbindje ndaj Allahut dhe ai që mohon ndonjë prej virtyteve të tyre, të mëdha apo të vogla, është mohues. Djeni se mohuesit janë gënjeshtarët dhe gënjeshtarët janë hipokritët (munafikët). Allahu i Lartësuar ka folur për hipokritët dhe fjala e Tij është e vërtetë: **“Hipokritët janë në shkallën më**

**të poshtme të zjarrit dhe për ta nuk do të gjesh ndihmues”.<sup>9</sup>**

Askush prej jush, që Allahu ia ka mbushur zemrën me bindje e me frikë ndaj Tij, të mos trembet nga askush prej njerëzve që Allahu i ka larguar nga e vërteta dhe nuk i ka bërë prej ithtarëve të saj, sepse kush nuk është prej njerëzve të së vërtetës, është prej djajve dhe xhindeve. Bërtet, djajtë e njerëzve kanë dredhi, mashtrime, hile e pëshpëritje që ua përcjellin njëri-tjetrit, me qëllim që, nëse munden, t’i largojnë ithtarët e së vërtetës nga nderi dhe drita që Allahu ua ka dhuruar përmes kuptimit të fesë së Tij, nga

---

<sup>9</sup> Sure “En Nisa”, ajeti 145.

e cila Allahu nuk i ka bërë pjesëtarë këta djaj të njerëzve.

Qëllimi i tyre është që armiqtë e Allahut dhe ithtarët e së vërtetës të bëhen të barabartë në dyshim, mohim dhe përgënjeshttrim, ashtu siç ka përshkruar Allahu në Librin e Tij: **“Ata dëshirojnë që edhe ju të mohoni (siç mohuan ata), që të bëheni të barabartë me ta”.**<sup>10</sup>

Pastaj Allahu i ndaloi njerëzit që ndihmojnë të vërtetën, që të mos marrin për miq dhe ndihmues armiqtë e Allahut. Prandaj, mos u frikësoni dhe mos lejoni që të ndaloheni nga ndihma për të vërtetën që Allahu ju ka veçuar me të, për shkak të

---

<sup>10</sup> Sure “En Nisa”, ajeti 89.

dredhive të djajve prej njerëzve dhe mashtrimeve të tyre. Ju i largoni të këqijat me atë që është më e mira në marrëdhëniet tuaja me ta, duke kërkuar me këtë kënaqësinë e Zotit tuaj në bindjen ndaj Tij. Por ata nuk kanë ndonjë të mirë. Nuk ju lejohet t'ua zbuloni atyre bazat e fesë së Allahut, sepse, nëse dëgjojnë diçka nga ju për këtë, do t'ju kthehen kundër, do t'ju hipin në kokë dhe do të përpiqen me gjithë forcën e tyre t'ju shkatërrojnë dhe do t'ju përballin me atë që e urreni. Në qeverisjen e të padrejtëve, ju nuk do të keni kurrfarë drejtësie prej tyre.

Prandaj njihni vendin tuaj përballë njerëzve të së kotës, sepse nuk është e denjë që njerëzit e së vërtetës ta ulin veten në

nivelin e njerëzve të së kotës. Allahu nuk i ka bërë njerëzit e së vërtetës të barabartë me ata të së pavërtetës. A nuk e kanë kuptuar kuptimin e fjalës së Allahut në Librin e Tij kur thotë: **“A t’i trajtojmë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira si ata që bëjnë shkatërime në tokë? A t’i trajtojmë të devotshmit si mëkatarët?”**<sup>11</sup>

Nderojeni veten tuaj, duke u larguar nga njerëzit e së kotës dhe mos e bëni Allahun e Lartësuar, as Imamët tuaj, as fenë tuaj që adhuron, të ekspozuar para njerëzve të së pavërtetës, që të mos zemërohet Allahu me ju e të shkatërroheni.

---

<sup>11</sup> Sure “Sad”, ajeti 28.

Ngadalë o njerëz të devotshëm! Mos e braktisni urdhrin e Allahut dhe urdhrin e atij që ju ka urdhëruar për bindje ndaj Tij, që Allahu të mos e ndërrojë gjendjen tuaj nga mirësi në sprova.

Duajeni, për hir të Allahut, atë që përshkruan cilësitë tuaja dhe urrejeni, për hir të Allahut, atë që ju kundërshton. Dhurojeni dashurinë dhe këshillën tuaj për ata që kanë cilësitë tuaja dhe mos e shpërdoroni atë për ata që janë larguar prej jush, që ju kanë armiqësuar dhe kërkojnë shkatërrimin tuaj. Ky është edukimi ynë, edukimi i Allahut, prandaj merreni, kuptojeni mirë, arsyetoni dhe mos e hidhni pas shpine.

Nëse diçka pajtohet me udhëzimin tuaj, merreni; por, nëse pajtohet me dëshirat tuaja, braktiseni. Mos bëni arrogancë ndaj Allahut, sepse nuk ka ndodhur që dikush të jetë sprovuar me arrogancë ndaj Allahut, përveç se ai do të tregojë arrogancë edhe ndaj fesë së Allahut.

Qëndroni të drejtë, për hir të Allahut dhe mos u ktheni prapa, sepse do të humbni. Allahu më ruajttë mua dhe juve nga arroganca ndaj Tij, sepse nuk ka fuqi dhe forcë përveçse te Allahu.

Kur robi është jobesimtar, ai nuk vdes, derisa e keqja t'i bëhet e dashur dhe t'i afrohet. E kur t'i bëhet e dashur e keqja dhe t'i afrohet, sprovohet me

mendjemadhësi dhe tirani. Atëherë zemra e tij bëhet e ashpër, sjellja e tij përkeqësohet, fytyra i ashpërsohet, shfaqet imoraliteti i tij, pakësohet turpi i tij, Allahu ia zbulon mbulesën (sekretet), ai kryen ndalesat dhe nuk largohet prej tyre, vepron mëkatet ndaj Allahut dhe urren bindjen ndaj Tij dhe ata që janë të bindur ndaj Allahut. Sa larg është gjendja e besimtarit nga ajo e jobesimtarit!

Kërkoni prej Allahut mirësi (shëndet shpirtëror) dhe luteni Atë për të, sepse nuk ka forcë e as fuqi përveçse me Allahun.

Jini të duruar ndaj sprovave të kësaj bote, sepse vazhdimi i sprovave dhe

vështirësive në bindjen ndaj Allahut dhe ndaj atyre që Allahu ka urdhëruar t'u bindeni, ka përfundim më të mirë tek Allahu në Botën Tjetër sesa sundimi i kësaj bote, edhe nëse zgjat me begatitë dhe zbukurimet e saj, por në mosbindje ndaj Allahut dhe në ndjekje të atyre që Allahu ka ndaluar t'u jepet përkrahje dhe bindje.

Allahu ka urdhëruar për ndjekjen e imamëve, të cilët Ai i ka përmendur në Librin e Tij, në fjalën e Tij: **“Dhe i bëmë ata imamë që udhëzonin me urdhrin Tonë”**. Këta janë ata që Allahu ka urdhëruar t'i ndjekim dhe t'u bindemi.

Ndërsa ata që Allahu ka ndaluar ndjekjen dhe bindjen ndaj tyre, janë

imamët e humbjes (udhëheqësit e së keqes), të cilët kishin një pushtet në këtë botë ndaj të dashurve të Allahut, imamëve nga familja e Muhamedit. Ata veprojnë në pushtetin e tyre në kundërshtim me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, që të përmbushet fjala e dënimit mbi ta.

Që ju të jeni me Profetin e Allahut, Muhamedin (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe me të dërguarit para tij, meditoni mbi tregimet që Allahu ju ka rrëfyer në Librin e Tij për sprovat që i kanë goditur profetët dhe ndjekësit e tyre besimtarë. Pastaj, luteni Allahun që t'ju japë durim në sprova, në begati e vështirësi, në varfëri e bollëk, ashtu siç u dha atyre.

Ruhuni nga grindjet me ndjekësit e së pavërtetës! Mbajuni udhëzimit të të drejtëve: qëndrimit të tyre fisnik, qetësisë, durimit, përulësisë së tyre, largimit nga ndalesat e Allahut, singëritetit dhe besnikërisë së tyre, dhe përpjekjes së tyre për ta bindur Allahun, sepse, nëse nuk veproni kështu, nuk do të arrini pozitën e të drejtëve para jush te Zoti juaj.

Dijeni se, kur Allahu dëshiron t'i japë mirësi dikujt, ia hap gjoksin për Islam. E kur ia jep këtë, e bën gjuhën e tij të flasë të vërtetën, e zemra e tij ta pranojë atë, dhe ai vepron sipas saj. Kur Allahu ia bashkon këto gjëra, atëherë Islami i tij bëhet i plotë dhe, nëse ai vdes në këtë gjendje, është tek Allahu nga myslimanët e vërtetë.

Por, nëse Allahu nuk dëshiron të mirën për një rob, ia lë vetvetes dhe gjoksi i tij bëhet i ngushtë e i rënduar. Nëse nga gjuha e tij del e vërteta, zemra nuk e përqafton atë. Nëse zemra nuk e pranon të vërtetën, Allahu nuk ia jep veprimin sipas saj. Kur këto gjëra i bashkohen atij dhe ai vdes në këtë gjendje, ai është tek Allahu nga hipokritët.

E vërteta që ka dalë nga gjuha e tij, por që Allahu nuk ia dha që ta besojë në zemër dhe ta veprojë me të, do të jetë dëshmi kundër tij në Ditën e Gjykimit. Prandaj, kini frikë Allahun dhe luteni Atë që t’jua hapë gjokset për Islamin dhe t’jua bëjë gjuhët të flasin të vërtetën, deri sa t’jua marrë shpirtin në këtë gjendje

dhe t’jua bëjë kthimin (pas vdekjes) si të të drejtëve para jush.

Nuk ka fuqi e as forcë, përveçse me Allahun. Lavdia i takon Allahut, Zotit të botëve.

Kush dëshiron të dijë, nëse Allahu e do, le të veprojë me bindje ndaj Tij dhe le të na ndjekë neve. A nuk e ka dëgjuar fjalën e Allahut të Madhëruar drejtuar të Dërguarit të Tij (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): **“Thuaj: ‘Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë mëkatet’”**.<sup>12</sup>

---

<sup>12</sup> Sure “Al Imran”, ajeti 31.

Pasha Allahun, asnjë rob nuk e bind kurrë Allahun pa e bërë Allahu që të na ndjekë neve! Pasha Allahun, askush nuk na ndjek kurrë ne pa e dashur Allahu! Pasha Allahun, kushdo që ndalon së na ndjekuri, padyshim që na urren. Pasha Allahun, askush kurrë nuk na urren, vetëm nëse është kundër Allahut! Kush vdes duke qenë kundër Allahut, Allahu do ta poshtërojë dhe do ta hedhë me fytyrë në zjarr.

Lavdia i takon Allahut, Zotit të botëve!”

اسم الكتاب: رسالة الإمام الصادق (ع) لأصحابه

المترجم: الحاج الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحيح الادبي والغوى: يريدا كولا

التصحيح الغوى: اسراء مريا

الاخراج النهائى و الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعية النسيم- تيرانا 2025